

# PËRSHKRIMI I ROLIT TË DREJTUESIT TË KM-së

Nga TODD MORR



[WWW.MISSIONALMADESIMPLE.COM](http://WWW.MISSIONALMADESIMPLE.COM)

# DREJTUESI I KOMUNITETIT MISIONAL

## PËRSHKRIMI I ROLIT TË TIJ

*Fokusi parësor i KM-së suaj është të bëjë dishepuj të Jezusit, të cilët bëjnë dishepuj.*

*Me këtë fokus, shpresohet që KM-ja juaj të shumëfishohet dhe si rrjedhojë të krijohen dy KM brenda 18-24 muajsh. Ti nuk po e bën këtë vetëm, por duke drejtuar së bashku me grupin bërthamë.*

## VETËUDHËHEQJA

### DISHEPULLIZIM PERSONAL:

- Reflektim i vazhdueshëm rreth Shkrimit dhe aplikim i Ungjillit në të gjitha fushat e jetës.
- Lutje e vazhdueshme dhe dëgjim i Shpirtit të Shenjtë për udhëheqje të përditshme në jetën tënde dhe atë të të tjerëve.
- Pjesëmarrje e vazhdueshme në trajnimet dhe përgatitjet për drejtues KM-je.
- Në rast se je i martuar, ndihmoje gruan dhe fëmijët të rriten në kuptimin e Ungjillit dhe aplikimin e Ungjillit.
- Praktikë e zakonshme e Sabatit, kalo kohë vetëm dhe pusho.

## TË UDHËHEQËSH DISA

### ZHVILLO DREJTUES TË RINJ NË GRUPIN BËRTHAMË:

- Ji i qartë me grupin bërthamë të KM-së dhe rezervo për ta energjinë tënde më të mirë, që t'i përgatisësh si shumëfishues të ardhshëm.
- Bashkë me grupin bërthamë krijo dhe përkushtoj një plani KM-je, që përmban detaje të misionit, duke bërë përshtatje në sezona të ndryshme kur është e nevojshme.
- Ndhijmoje grupin bërthamë të kuptojë talentet e tyre unike tek Efesianët 4 (APUBM, apostujt, profetët, ungjillorët, barinjët dhe mësuesit) dhe kontributin, që mund të japin te një KM.
- Ndhijmoje grupin tënd të rritet në mënyrën se si e udhëheqin ata veten (shiko më lart).
- Ndhijmoje grupin tënd të rritet në qëndrueshmëri ndërsa e jetojnë jetën sipas identitetit të tyre si Familje, Misionarë, Shërbëtorë dhe Nxënës.
- Ndhijmo secilin prej tyre të mbajë disa marrëdhënie (3-5) me jo të krishterët për të cilët ata po luten dhe po ndikojnë vazhdimisht te Jezusi.
- Krijo një kulturë lutjeje me grupin bërthamë, në mënyrë që për ata dhe për të tjerët në KM të ketë vazhdimisht lutje.
- Nga KM-ja krijo aq Grupe DNA-je sa të jetë e mundur dhe kujdesu vazhdimisht për ta.
- Takohu me grupin bërthamë të paktën një herë në muaj për të festuar progresin, për të bërë ndryshime të nevojshme dhe për të planifikuar për muajin tjetër.



## TË DREJTOSH NJË KOMUNITET

### TË JETOSH NË MISION ME NJË FAMILJE DISHEPUJSH

- Përmes ritmit të zakonshëm të jetës, drejtoje KM-në të krijojë marrëdhënie me miqtë ende jo të krishterë të njëri-tjetrit; ata miq që KM-ja juaj i ka identifikuar dhe për të cilët është thirrur t'i bëjë dishepuj.
- Ndiemoje KM-në tënde të zhvillojë aftësi për t'i nxitur të tjerët të ndajnë historitë e tyre, ndërsa ata vetë t'i komunikojnë historitë e tyre me fokusin tek Ungjilli.
- Drejtoje vazhdimisht KM-në t'u shërbejë "vëllezërve më të vegjël" në mënyra të dukshme. Kjo përfshin investim në kohë, burime, marrëdhënie dhe lutje.
- Drejtoje vazhdimisht KM-në në:
  - Lutje për ata, që nuk janë ende të krishterë.
  - Shërbeju atyre, që nuk janë ende të krishterë si manifestim të Ungjillit.
  - Folu dhe tregoj për Ungjillin.
- Drejtoje KM-në përmes Mënyrës Historiformuese me disa ende jo të krishterë për të paktën një herë në vit.
- Drejtoje me përkushtim KM-në përmes procesit të shumëfishimit, duke i ndihmuar të kuptojnë vizionin dhe "pse-në" pas shumëfishimit. Ndërsa shumëfishohen, ndihmoji teksa kalojnë përmes ndryshimit dhe teksta festojnë rritjen.
- Drejtoje KM-në tënde të bashkëpunojë me KM të tjera në qytetin tënd në mënyrë që ndikimi i ungjillit të jetë më i madh në zonat dhe njerëzit për të cilët Zoti të ka thirrur.

*E kam lexuar dhe diskutuar këtë Përshkrim të Rolit. I përkushtohem me përlujtë mësimi dhe rritjes në të gjitha këto fusha. Me hirin e Zotit dhe fuqinë e Shpirtit të Shenjtë, e bëj këtë besëlidhje me komunitetin tim që do të bëjë më të mirën time për t'i përmbushur këto zotime.*

EMRI: \_\_\_\_\_

DATA: \_\_\_\_\_

EMRI: \_\_\_\_\_

DATA: \_\_\_\_\_

